



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

29,7% e bizneseve aktive menaxhohen nga gratë

Editorial

Sipas INSTAT, "Regjistri i Ndërmarrjeve", botuar më 1

qershor 2018, rezulton se numri i bizneseve ku pronare apo drejtohen nga gratë, në vitin 2017 pësoi një rritje me 2.9 pikë përqindje në krahasim me vitin 2016, duke arritur në 29,7% të totalit të ndërmarrjeve aktive, por përsëri më pak se në vitin 2015 ku përbënin 31,3%.

Aktiviteti tregtar shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave menaxhere, me 39,2%. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht biznese shumë të vogla me 1- 4 të punësuar, të cilat zënë 91,6 % të

numrit të përgjithshëm. Megjithatë, gratë drejtojnë 24,2% të ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar, nga 19,2% që drejtonin këtë grup gjatë vitit 2016.



Përqindja me e lartë e grave menaxhere është në bashkinë e Tiranës, ku gratë menaxhojnë 36,5 % të bizneseve.

Ndërsa përqindja me e ulët e grave menaxhere

është në bashkinë e Maliqit me 13,3%.

Buletin Informativ


Verë 2018

NË KËTË NUMËR

Ndikimi i kursit të këmbimit në eksportet shqiptare

Në vitin 2017 eksportet shqiptare përbëjnë 32% të PBB-së, raport i cili ka ardhur në rritje në vitet e fundit.

Faqe 3



Programet financuese të BE-së për SME-të

Më datë 19.07.2018, në mjediset e Qendrës së Informacionit të BE-së në Tiranë, u mbajt takimi informues për programet financuese të BE-së.

Faqe 2



Programet financuese të BE-së për SME-të: Pronësia Industriale dhe e Drejta e Autorit

Më datë 19 korrik 2018, në mjediset e Qendrës së Informacionit të BE-së në Tiranë, pranë Pallatit të Kongreseve u mbajt takimi informues për programet financuese të BE-së, i organizuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor & Inovacionit (AKKSHI), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Inestimeve (AIDA) dhe Drejtoria e Përgjithëshme e Pronësisë Industriale (DPPI). Npërmjet këtij aktiviteti, pjesëmarrësit u njohën me Instrumentin e SME-ve të Programit H2020 të BE-së, i cili ofron grante në secilën nga 3 fazat e aplikimit për SME-të e çdo fushe që kanë ide inovative për produkte.



Konkursi IDEA për plane biznesi



Në kuadër të Konkursit **IDEA** për plane biznesi, gjatë muajve qershor-korrik

vazhdojnë trainimet. Sfidës IDEA i janë bashkuar 200 gra sipërmarrëse dhe 15 trainere.

Ky projekt mbështet të rinjtë që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes prej më pak se 3 vjet.

Konkursi IDEA ofron një paketë të plotë mbështetjeje nëpërmjet seancave tërheqëse të trajnimit, coaching/këshillim, mentorim dhe fituesve do t'u ofrohet grant.

Linku i IDEA në facebook:

www.facebook.com/ideaalbania

Bankat dhe biznesi

Ndikimi i kursit të këmbimit në eksporte

Në vitin 2017 eksportet shqiptare përbëjnë 32% të PBB-së, raport i cili ka ardhur në rritje në vitet e fundit, përkundrajt 26% që zinte në vitin 2009. Në aspektin teorik një mbiçmim i kursit të lekut ndaj monedhave të huaja ndikon në shtrenjtimin e eksporteve tona.


Ky shtrenjtim do të ndikonte në uljen e konkurrueshmërisë së bizneseve në tregjet e huaja si dhe ndoshta në rënien e kërkesës për këto produkte. Për më tepër ndikimi është

akoma më i madh nëse mendojmë që shumë prej kontratave të eksportuesve nënshkruhen një vit më parë dhe përgjithësisht ato faktorizojnë kursin e këmbimit të lekut ndaj euros të asaj periudhe. Si të tilla këto çmime të nënshkruara që përbëjnë dhe të ardhurat e tyre për gjithë vitin aktual do të ngushtonin ndjeshëm marxhin e fitimit.

Gjithsesi, kjo humbje nga çmimet e kontraktuara materializohet në ato biznese eksportuese të cilat shpenzimet i kanë në lekë, por të ardhurat i kanë në valutë dhe paralelisht nuk kanë ndërmarrë asnjë mbrojtje natyrale për të mbuluar këtë kosto shtesë.

Një ndikim të drejtpërdrejt i kursit në eksportet tona ka edhe për ato

produkte të cilat prezantohen për herë të parë në tregun evropian dhe mundësia e eksportuesve vendas për të diktuar një çmim më të lartë është e ulët. Gjithsesi këto implikime deri diku shuhën



nëse kemi parasysh natyrën e produkteve tona. Pjesa më e madhe e eksporteve tona të mallrave (prej 36%) janë rieksperte në sektorin e fasonerisë të tekstileve dhe këpucëve. Këto biznese çmimit final të këtyre produkteve ju shtojnë vetëm vlerën e shërbimeve të krahut të punës që kryesisht janë të paguara në lekë, dhe ndërkohë marxhi i ulët i fitimit vështirë se është në nivele që të mbulojë një humbje të tillë nga kursi. Ndikimi në këto biznese është relativisht i lartë, prandaj aplikimi i skemave mbrojtëse nga luhatjet e kursit do të ishte një domosdoshmëri. Megjithatë aktualisht këto biznese janë në momentet e përshtatshme të nënshkrimit të

kontratave të reja dhe një faktorizim i një kursi mbiçmues në të ardhmen do të ishte një mbrojtje e përshtatshme për të rikuperuar dhe eliminuar humbjen aktuale.

Një tjetër kategori produktesh të eksportuar nga bizneset tona janë ato që lidhen me mallrat bazë, të tilla si minerale dhe energjia.

Pesha e tyre në fund të vitit 2017 ishte rreth 26% të totalit të mallrave të eksportuara. Çmimet e tyre përcaktohen gjerësisht nga bursat ndërkombëtare dhe janë të kuotuar në dollar. Për vetë natyrën e këtyre produkteve, (një inelasticitet i ulët ndaj luhatjeve momentale të çmimeve) nënkupton se kërkesa

për to nuk duhet të ndikohet nga faktorizimi i këtij fenomeni në çmimet e produktit. Gjithsesi, në tërësi duke marrë parasysh natyrën e produkteve shqiptare me inelasticitet të ulët ndaj çmimit, ndikimi i përgjithshëm i kursit në eksporte mendohet të jetë minimale dhe me tepër pritët të ndikojë në konkurrueshmërinë e tyre në tregjet e huaja në të ardhmen.

Një tjetër sektor i cili influencohet nga lëvizjet në kursin e këmbimit është ai i shërbimeve. Ky sektor është dhe sektori me pjesëmarrjen më të lartë të SME-ve dhe në veçanti të bizneseve mikro.

Krijohet Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar. Sekretariati do të jetë institucion buxhetor publik në varësi të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me seli në mjediset e Kryeministrit.

Referuar vendimit, Sekretariati Teknik ka si qëllim t'u mundësojë bizneseve të adresojnë shqetësimet e tyre dhe të gjejnë përkrahje në mënyrë që propozimet e tyre t'u përcillen institucioneve politikëbërëse dhe vendimmarrëse, për reduktimin e

pengesave administrative me të cilat ndeshet biznesi në veprimtarinë e përditshme, të evidentuara si problematike,



nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes dhe klimës së biznesit në Shqipëri.

Sekretariati teknik do të financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm ndërsa për periudhën deri në miratimin e fondeve përkatëse të buxhetit të shtetit për plotësimin me personel organik, detyrat e sekretariatit teknik do të përmbushen nga punonjës të komanduar ose të punësuar me kontratë të përkohshme.

Të shpresojmë që funksionimi i sekretariatit do të fillojë sa më parë dhe me efektivitet në mbështetje të bizneseve!
(Burimi: scan TV)

Projekti Interreg-IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi



Më datë 17 korrik 2018, në sallën e Këshillit Bashkiak të Malësisë së Madhe u mbajt Seminari informues për projektin rajonal "P.A.S.T.4 Future" "Nxitja e turizmit të qendrueshëm dhe për njerëzit me paafësi fizike", ku partner lider është Ministria e Financës & Ekonomisë së Shqipërisë dhe me partner të tjerë Bashkinë e Malësisë së Madhe, si dhe dy partner nga Italia dhe dy partner të tjerë nga Mali i Zi.

Në këtë takim merrnin pjesë Kryetari i Bashkisë së Malësisë së Madhe, përfaqësues nga Ministria e Financës & Ekonomisë, nga partnerët e projektit. Nga përfaqësues të partnerëve u bë prezantimi i projektit me kohëzgjatje 2 vjet dhe që do të pilotohet në zonën e Malësisë së Madhe me krijimin e infrastrukturës së përshtatshme edhe për personat me aftësi të kufizuara fizike; për krijimin e web platform si dhe menaxhimin e turizmit ndërkufitar. Kjo do të bëjë të mundur që turizmi i Aksesueshëm dhe i Qendrueshëm të bëhet timoni i zhvillimit të zonave rurale ndërkufitare.

Vazhdon aksioni i tatimorëve për kontrolle në bizneset në bregdet

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve pas njoftimit që bëri në fillim të qershorit për nisjen e kontrollit të zbatimit të planit të masave për zbatimin me korrektësi të legjislacionit tatimor, nga tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari në zonat turistike, në mbarë vendin, deklaroi se:



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka bërë një bilanc të masave të marra për sezonin turistik. Në fokus të aksionit ishte ulja e evazionit fiskal, rritja e të ardhurave tatimore, regjistrimi i të punësuarave dhe ndërgjegjësimi për tërheqjen e kuponit tatimor.

Për periudhën Qershor-Korrik 2018 sektori i hetimit tatimor kontrolloi 5,040 subjekte, nga të cilat 2,000 u konstatuan me shkelje. Masat administrative për këto shkelje arrijnë në **75.2 milionë lekë**.

Ndërkohë rreth 200 subjekte janë detyruar të regjistrohen në organet tatimore pas konstatimit se ushtronin veprimtarinë, kryesisht akomoduese, në mënyrë informale. Në sektorin e punësimit, formalizimi solli si rezultat regjistrimin si të punësuar të mbi 14,000 individëve, pjesa më e madhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës (5,458), DRT Vlorë (3,377) dhe DRT Sarandë (2,208).

Në total, numri i tatimpaguesve të konstatuar me punonjës të padeklaruar ishte 320, ndërsa tashmë këta punonjës janë futur në skemën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore.

Sa i takon mbledhjes së detyrimeve me forcë, 290 debitorë janë kontaktuar nga organet tatimore dhe janë arkëtuar rreth 35 milionë lekë detyrime të prapambetura.

Po ashtu, si rezultat i kontrollit tatimor, 510 tatimpagues kanë rritur detyrimin për pagesën e TVSH, një rritje rreth 463% më e lartë krahasuar me sezonin turistik të vitit të kaluar.

Administrata Tatimore, me të gjitha strukturat e saj, njofton se është e angazhuar për të qenë në çdo kohë e pranishme në territor, për të kontrolluar dhe verifikuar nga afër situatën në të gjitha zonat turistike të vendit.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, u tërheq vëmendjen bizneseve që ushtrojnë aktivitetin në këtë sektor, për respektimin e

detyrimit për të regjistruar të gjithë punonjësit e angazhuar me kohë të plotë, të pjesshme, apo në peridhë prove **të paktën një ditë kalendarike** përpara fillimit të punës në zbatim të nenit 119 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Paga minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është 24,000 lekë/muaj.

Gjithashtu, detyrimi për përfshirjen në skemën e sigurimeve shoqërore është edhe për studentët, të cilët punësohen në subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në sektorin e turizmit" njoftojnë Tatimet. Po ashtu, Tatimet këshillojnë bizneset që të bëjnë kujdes pasi "studentët trajtohen njësoj si të gjithë të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj"

Nëse, nga verifikimi dhe kontrolli që do të ushtrohet nga Administrata Tatimore do të rezultojë se tatimpaguesi nuk ka deklaruar çdo të punësuar, përveç *detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, atëherë ai do t'i nënshtrohet sanksioneve përkatëse. Nëse është tatimpagues i biznesit të madh, gjopa llogaritet në 200,000 (dyqind mijë) lekë dhe nëse është tatimpagues i biznesit të vogël, atëherë penalteti është 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë.*

Burimi: <https://www.tatime.gov.al>

Paketa fiskale e mesvitit, të gjithë taksat që ndryshojnë për bizneset

nga **Violeta Shqalsi**

Qeveria ashtu sikurse kishte paralajmëruar ka miratuar një seri projektligjesh që lidhen me sistemin e taksave në vend. Kjo u quajt si paketa fiskale e mesvitit dhe synon lehtësimin e sektorit të agroturizmit si dhe vendosjen e një regjimi të ri sa i përket tatimit mbi të ardhurat. Por cilat janë në fakt taksat që ndryshojnë.

Projektligji për tatimin mbi të ardhurat

Ndryshon shkalla tatimore e biznesit. Shkalla e tatimit mbi fitimin është: 15% për tatimpaguesit me të ardhura gjithsej mbi 14 mln lekë në vit; 5% për tatimpaguesit me të ardhura gjithsej 14 mln lekë në vit. Aktualisht paguhet 15% për tatimin mbi 8 mln lek dhe 5% deri në 8 mln lek.

Për të gjithë subjektet që certifikohen për aktivitetin e agroturizimit shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Norma e

reduktuar e tatimit mbi fitimin 5 % e parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato

struktura, të cilat përfitojnë statusin "subjekt i çertifikuar agroturizmi" deri në dhjetor 2021. Efektet e normës së reduktuar fillojnë në vitin pasardhës pas

përfitimit të statusit "subjekt i certifikuar agroturizmi". Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas Ligjit Nr. 38/2012 "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Për lojrat e fatit drafti bën një riformulim më të saktë të ligjit për atë se çfarë do të quhen të ardhura bruto nga loja duke cilësuar se taksimi do të bëhet pas zbritjes së fitimit nga loja.

Projektligji për taksat vendore

Në këtë projektligj qeveria ka vendosur të bëjë vetëm një ndryshim i cili lidhet me përjashtimin e subjekteve të çertifikuara në agroturizëm nga pagesa e taksës së infrastrukturës.

"Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e personave juridike "subjekt i certifikuar agroturizmi", të të

kryera në fushën e agroturizmit, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 93/2015 "Për Turizmin" dhe kur

veprimtaria e tyre është në përputhje me kriteret dhe rregullat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 12.01.2018 "Për miratimin e kriterëve për



certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit."

Projektligji Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

TVSH-ja e reduktuar në shkallë 6 për qind ofrohet vetëm për shërbimin e fjetjes në strukturat akomoduese ndërkohe që për strukturat me status special me 5 yje furnizim me 6 për qind do të jetë edhe për shërbimet e tjera që ofrohen në këto struktura nga bar restorant, masazhe, sauna.

Tashmë qeveria ka vendosur të zgjerojë bazën e atyre që përfitojnë nga shkalla 6 për qind edhe tek agroturizmi.

"Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 %, aplikohet për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit, me përjashtim të furnizimit të pijeve, të ofruara brenda strukturave në të cilat zhvillohet veprimtari pritëse e çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit" thuhet në draft.



FAKTE

29.7%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2017 në Shqipëri rezultojnë 29.7% me një ritje prej 2.9 pikë % krahasuar me 2016, por me një rënie me 1.6 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)



3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e Shqipërisë)



Dita e Ligenit në Strugë

Më 21 qershor 2018 u organizua në Strugë takimi në kuadër të Ditëve të Ligenit.

Një delegacion i SHGPAZ, i drejtuar nga presidentja znj.Flutura Xhabija, mori pjesë në këtë aktivitet.



Hapet sezoni turistik në Pogradec

Më 16 qershor 2018 çelët sezoni
turistik në Pogradec. Bizneseve të
Pogradecit i urojmë suksese në kë
të sezon turistik



Gruaja dhe shëndeti

Nervi shiatik

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Nervi shiatik është nervi më i gjatë dhe më i madh në trup – ai është aq i trashë sa një prej gishtërinye tanë kur arrin në pjesën e shpinës. Ai pastaj kalon nga pjesa e prapme drejt ijeve dhe poshtë tek këmba nga ku ndahet në gju në dy degë.

Problemet e nervi shiatik haset më tepër tek të rinjtë që punojnë në profesione që kërkojnë ngritje peshash. Megjithatë, kohët e fundit është vënë re një tendencë në rritje e rasteve te personat, që qëndrojnë për një kohë të gjatë në një pozicion të palëvizur, siç mund të jetë përpara kompjuterit apo në timon. Nga nervi shiatik, preken më tepër meshkujt, megjithatë është rritur dhe numri i femrave, kryesisht amvisat që bëjnë punë në ambientet e shtëpisë me ngritje peshash.

Cilat janë simptomat?

Dhimbja nga shiatiku mund të ndihet thellë në pjesën e prapme, me dhimbje që shkon drejt shpinës dhe poshtë për në këmbë, nganjëherë edhe në shputën e këmbës. Dhimbja mund të jetë e shoqëruar me ndjesi shpimi gjilpërash – “gjemba” apo mpirje dhe nganjëherë nga dobësia muskulare e këmbës. Dhimbja e shiatikut ndihet zakonisht vetëm në një këmbë. Ndonjëherë, një ndjesi si një goditje elektrike mund të ndihet përgjatë nervave. Në shumicën e rasteve dhimbja e shkaktuar nga nervi



shiatik është e forte dhe ka karakter mekanik.

Cili është shkaku i dhimbjes?

Hernia diskale

Një nga shkaqet më të zakonshme të dhimbjeve nervit shiatik është hernia diskale. Hernia nënkupton fryrje. Disqet intervertebrale janë disqe që formojnë një mbrojtje mes rruazave të shtyllës kurrizore. Disqet kanë një shtresë të fortë të jashtme të përbërë nga kërci, me një qendër të butë xhelatinoze që vepron si një amortizues. Nëse shtresa e jashtme e diskut dobësohet, nga mosha apo lëndimi, pjesa e butë mund të pësojë fryrje dhe zhvendoset duke kaluar te pjesa e çarë e diskut; kjo është ajo që është e njohur si një hernie diskale ose thyerje. Nëse ndonjë prej pesë çifteve të rrënjëve nervore që formojnë origjinën e nervit shiatik janë të ngjeshura në shpinë nga një disk i thyer ata mund të japin një rritje të dhimbjes poshtë nervit shiatik. Gjithashtu, edhe kimikatet që derdhen nga qendra e butë e diskut irritojnë rrënjët nervore, duke shkaktuar inflamacion.

Si trajtohet shiatiku?

Kontrolli i dhimbjeve

Shpesh dhimbja kalon brenda 24 orëve dhe medikamentet anti-inflamatore jo-steroidale, si

ibuprofeni ose voltareni, ndihmojnë në kontrollin e dhimbjes dhe zvogëlimin e inflamacionit. Në pjesën dërrmuese të rasteve i sëmuri duhet t'i drejtohet mjekut për trajtim të mëtejshëm.

Të qenit aktiv

Pasi dhimbja është kontrolluar, është e domosdoshme një terapi fizike ose një program ushtrimesh për të forcuar muskujt e shpinës dhe për të rregulluar qëndrimin. Terapia fizike është e rëndësishme sidomos nëse hernia diskale është prezente. Një sërë ditësh pushim do të jenë të nevojshme, por jo më gjatë pasi muskujt e shpinës do të fillojnë të dobësohen. Mbajtja e aktivitetit fizik siguron një efekt pozitiv mbi dhimbjet.

Kura natyrale në kushte shtëpie

Një nga mënyrat më të suksesshme që ka dhënë rezultate në lehtësimin e dhimbjeve, janë masazhet me vaj dhe akull. Masazhet duhet të bëhen çdo ditë për 30 minuta çdo seance dhe duhet të vazhdojnë për 15 ditë. Për përmirësimin e dhimbjeve të nervit shiatik shërben edhe kura e përfutur nga përzierja e 100 gramë jodio, 30 gramë vaj gruri, 4 lugë gjelle vaj ulliri, 30 tableta aspirinë dhe një kuti rozmarinë të njomë. Të gjitha këto përzihen së bashku në një enë dhe lihen në qetësi për 5 orë. Pasi kjo përzierje të marrë trajtën e pomadës, bëhet masazhi i këmbës për 15 deri në 20 minuta, atje ku nervi shiatik është i ngacmuar. Kjo kurë vazhdon për 7 deri në 10 ditë rresht.

CEFTA-rregullat doganore të produkteve ushqimore dhe të luksit

Më qershor 2018, Dhoma e Tregtisë Tiranë me mbështetje të GIZ organizuan në ambjentet e hotel Sheraton seminarin për rregullat doganore të produkteve ushqimore dhe të luksit, në kuadër të marrëveshjes CEFTA.



Studimi: Trajtimi fiskal i OJF-ve

Në kuadër të punës së saj për krijimin e një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri, Partnerët Shqipëri ka përgatitur një studim mbi kuadrin fiskal që rregullon sektorin, i cili trajton ndër të tjera problematikat që kuadri aktual mbart si dhe rekomandime për adresimin e tyre.

Një ndër çështjet më problematike të theksuara edhe në studim është rimbursimi i TVSH për shpenzimet e mbështetura nga donatorët që kanë një marrëveshje bashkëpunimi me qeverinë shqiptare, ku programet e BE-së zënë vendin kryesor. Si pjesë e përpjekjeve të një grupi të përbashkët pune të ngritur midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Delegacionit të BE-së



dhe shoqërisë civile përfaqësuar nga Partnerët Shqipëri, pritet që së shpejti të dalë një procedurë e re për rimbursimin e TVSH-së që do të sjellë disa lehtësi dhe do të rrisë gamën e organizatave që do të përfitojnë, duke dhënë edhe më shumë garanci për zbatimin e saj.

Buletin Informativ

Verë 2018

Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com



Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia

Kalendari i Panairove në Poloni Shtator-Nëntor 2018

SEPTEMBER	 SCHPiME Forum of dentistry, plastic surgery and cosmetic medicine 6-8.09.2018 SCHPiME - FORUM of dentistry, plastic surgery and cosmetic medicine	 beautydays 21-23.09.2018 Beauty Days	 MIĘDZYNARODOWE TARGI BRANŻY KOMUNALNEJ 25-27.09.2018 Exhibition of Installations and technologies dedicated to municipal and urban economy			
OCTOBER	 home expo 14-16.10.2018 International Interior Design Fair	 BUILDING INDUSTRY SOLUTIONS 09-11.10.2018 Industry Building Solutions	 world TRAVEL SHOW 19-21.10.2018 International Tourism Fair	 CAMPER & CARAVAN SHOW 19-21.10.2018 Camper and Caravan Show	 Warsaw Yacht Salon 19-21.10.2018 Warsaw Salon Yacht	 WARSAW MOTO SHOW 26-28.10.2018 International Moto Fair
NOVEMBER	 WARSAW INDUSTRY WEEK 13-15.11.2018 Industry Solutions Trade Fair	 PAWILON POLSKICH INSTYTUTÓW 13-15.11.2018 Industry Solutions Trade Fair	 fast textile 13-15.11.2018 International Trade Fair for the Textile Industry	 CTR 2018 30.11-02.12.2018 International Agriculture Fair		